



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2979 Prot.

Rrëshen, me 29. 2. 2024

THIRRJE PUBLIKE PËR KËSHILLIN VENDOR TË RINISË

Bashkia Mirditë shpall thirrjen publike për anëtarësim në Këshillin Vendor të Rinisë. Kjo thirrje shpallet në zbatim të ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë" si dhe Vendimin Nr.28 datë 29.03.2022 të Këshillit Bashkiak Mirditë. Thirrja është e hapur për të gjithë të interesuarit dhe që plotësojnë kriteret. Kandidati/ja duhet të jenë banorë të bashkisë dhe të mos hës prej 15 deri 29 vjeç. Përzgjedha mes individëve që kanë shprehur interes bëhet nga grupi i punës përgjegjës i ngritur pranë Bashkisë duke u bazuar në kriteret dhe procedurat që parashikon ligji.

Kandidatët përfaqësues të organizatave rimore ose për të rinjtë, si dhe të rinjt aktiv të Njësis Administrative duhet të përbushin kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë përfaqësuestë një organizate rimore ose për të rinjtë;
- b) të mos jetë i dënuar;
- c) të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rimore dhe për të rinjtë;
- d) të mos ketë konflikt interes i për shkak të angazhimit të KVR;

*Për të rinjt aktiv të Njësisë Administrative nuk është kusht pika a) e mësipërme.

Kandidatët për KVR, përfaqësues të organizatave rimore ose për të rinjtë dhe të rinjt aktiv të Njësis Administrative, duhet të paraqesin interesin e tyre, në adresën: Bashkia Mirditë, Zyra e Shërbimeve me një Ndalesë si dhe elektronikisht info@bashkiamirdite.gov.al brenda afatit duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin dhe motivimin për aplikim;
- b) jetëshkrim (CV);
- c) fotokopje të dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- d) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- e) vetëdeklarim lidhur me shmangjen e konfliktit të interesave;
- f) referanca nga të paktën 2 bashkëpunëtorë të mëparshëm;

*Për të rinjt aktiv të Njësisë Administrative nuk është kusht pika f) e mësipërme.

Thirrja për kandidatët e KVR-së, do të qëndrojë e hapur për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh nga postimi ne webin zyrtare dhe rrjetet sociale te Bashkisë Mirditë. Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedha e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mylljes së aplikimeve.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe në rrjetet sociale të institucionit.



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al